



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova, kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), parashtruar kundër Vendimit Nr.01/3394-2025 datë 24.11.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për miratimin e formulës për përbërjen e Anëtareve të Komisioneve Komunal të Zgjedhjeve-KKZ, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.2/2025 datë 26.11.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Liberale e Egjiptiane (PLE), me të cilën ka kërkuar që të obligoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, që të anuloj vendimin nr.01/3394-2025 datë 24.11.2025, për miratimin e formulës për përbërjen e Anëtareve të Komisioneve Komunal të Zgjedhjeve-KKZ, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 26.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), parashtruar kundër vendimit të KQZ-se vendimin Nr.01/3394-2025 datë 24.11.2025 të KQZ-së për përbërjen e anëtarëve të komisioneve komunale zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 Dhjetor 2025. Vendimi i KQZ-së e disfavorizon (diskriminon) dukshëm PLE-në për faktin se si parti e komuniteti egjiptian na janë ndarë vetëm tri komuna për anëtar të KKZ-ve, përkatësisht komunat në: Gjakovë, Fushë Kosovë dhe Klinë. Për dallim prej partisë tjetër, nga po i njëjti komunitet, pra IRDK-së që me këtë vendim i janë ndarë shtatë komuna si në vijim: Gjakovë, Fushë Kosovë, Klinë, Istog, Pejë, Ferizaj dhe Mitrovicë të Jugut. Nga kjo mund të shihet dukshëm se ne jemi trajtuar të pabarabartë dhe sipas nesh vendimi i KQZ-së është i anshëm dhe i padrejtë. Ne si PLE bazuar edhe në realitetin e rezultateve të zgjedhjeve qendrore dhe lokale të fundit do të duhej të kishim anëtar të KKZ-ve edhe në komunat e Pejës, Istogut, Deçanit, Rahovecit, Obiliqit, Ferizajit dhe Prizrenit. Duke qenë pretendues për të arritur rezultatet të mira në

komunat në fjalë për shkak se kemi votues potencial, e vlerësojmë se duke mos pasur anëtar të KKZ-ve të cilët kanë për obligim të udhëheqin dhe mbikëqyrin mbarëvajtjen e procesit zgjedhorë, prandaj e konsiderojmë që në jemi përjashtuar padrejtë nga ky proces. Andaj, kërkojmë nga PZAP që të shqyrtoj të gjitha faktet dhe rrethanat bazuar gjithnjë në rregulloren e KQZ-së, regjistrimin e popullsisë, rezultatet e zgjedhjeve si dhe nevojën e madhe për të qenë pjesë e procesit zgjedhjeve të e pranoj ankesën tonë duke na dhënë të drejtën neve si PLE të jemi anëtar të KKZ-ve në komunat si në vijim: Pejë, Istog, Deçan, Obiliq, Ferizaj dhe Prizren. Të bashkangjitur e gjeni dhe vendimin për ndarjen e vendeve për anëtar të KKZ-ve.

Në përgjigjen në ankesë të KQZ-së, të datës 27.11.2025, ka theksuar se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën tuaj ju njofton se bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 08/L-228 neni 67 par. 3 shprehimisht thuhet se KQZ duhet të përpiqet të garantoj përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha Komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen gjinore. Komuniteti Egjiptian është i përfaqësuar në KKZ-të në komunat: Gjakovë, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Pejë dhe Ferizaj. Për sa i përket përfaqësimit të subjekteve politike tek i njëjti komunitet, nuk është obligative që numri i anëtarëve në KKZ të jetë i njëjte për subjektet politike nga komunitetet. Shembull: subjektet politike nga komuniteti Serb dhe Boshnjak, nuk kanë përfaqësim të njëjtë në Komisionet Komunale Zgjedhore. Dy subjektet politike nga komuniteti Serb, njëri subjekt ka përfaqësim në 18 Komisione Komunale të Zgjedhjeve, ndërsa subjekti tjetër ka përfaqësim në 16 Komisione Komunale të Zgjedhjeve. Tri subjektet politike nga komuniteti Boshnjak, njëri subjekt ka përfaqësim në 5 Komisione Komunale të Zgjedhjeve, subjekti i dytë ka përfaqësim në 2 Komisione Komunal Zgjedhore, ndërsa subjekti tjetër ka përfaqësim në 1 Komision Komunal të Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 01/3394-2025 të datës 24.11.2025 për miratimin e Rekomandimit për Emërimin e Anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për Zgjedhjet Lokale 2025, nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore për sa i përket pretendimeve të palës. Përbërje e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve është bërë bazuar në nenin 67 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 08/L-228 dhe Rregullores Zgjedhore 02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve. Formula për emërimin e KKZ-ve është bazuar edhe në këto kritere: Rezultatet e Zgjedhjeve të dates 9 shkurt 2025 në nivel qendror dhe nivel komunal dhe të dhënat nga raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga Regjistrimi i Popullsisë 2024.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 69 paragraf 7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe nenin 4 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-së, lidhur me mos emërimin e anëtarëve nga radhët e subjektit politik PLE, si anëtar i KKZ-së

në Komunat: Pejë, Istog, Deçan, Obiliq, Ferizaj dhe Prizren, nuk qëndrojnë, kjo duke u bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 67 par. 1, nen par. 1.2 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“nga një (1) anëtarë i nominuar nga subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor”*, ndërsa në nenin 67 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në mënyrë decitive thuhet se *“KQZ-ja duhet të përpiket ta garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen gjinore”*.

Paneli i vlerësoj si të pa bazuara pretendimet ankimore të cekura më lartë nga se subjekti në fjalë ni ka dëshmuar se cila ishte baza ligjore që ishte shkelur në këtë rast që ka ndikuar në një vendim të padrejtë dhe të pa barabart të subjektit PLE në raport me Subjektin tjetër IRDK-së.

Pretendimi se: ne si PLE bazuar edhe në realitetin e rezultateve të zgjedhjeve qendrore dhe lokale të fundit do të duhej të kishim anëtar të KKZ-ve edhe në komunat e Pejës, Istogut, Deçanit, Rahovecit, Obiliqit, Ferizajit dhe Prizrenit, mirëpo për të vërtetuar këto pretendime nuk ka paraqitur dëshmi se cili ishte realiteti i zgjedhjeve në krahasim me subjektin tjetër.

Mbi Bazën e të lartëcekurave Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr.01/3394/2025 datë 24.11.2025, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 67 par. 1, nen par. 1.2 dhe par. 3 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sepse Komuniteti Egjiptian është i përfaqësuar në KKZ-të në komunat: Gjakovë, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Pejë dhe Ferizaj. Përbërja e KKZ-ve, është bërë bazuar në nenin 67 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore 02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve të KQZ-së, në bazë të Formulës për emërimin e KKZ-ve, si dhe duke u bazuar në kriteret Rezultatet e Zgjedhjeve të datës 9 shkurt 2025 në nivel qendror, dhe nivel komunal dhe të dhënat nga raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga Regjistrimi i Popullsisë 2024, ku në nenin 2 par.1 të Rregullores 02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve ndër të tjera thuhet se *“...se KQZ vendos në bazë të numrit të banorëve dhe numrit të votave të atij subjekti politik në komunën përkatëse”*. Ndërsa sa i përket përfaqësimit të subjekteve politike tek i njëjti komunitet, nuk është obligative që numri i anëtarëve në KKZ, të jetë i njëjtë për subjektet politike nga komunitetet.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, se KQZ të ketë zbatuar gabimisht dispozitat ligjore dhe rregullat zgjedhore, dhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Janë vlerësuar edhe pretendime tjera ankimore të parashtruesit të ankuesit, por paneli nuk ka gjetur se vendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Prandaj, nga arsyet e parashtruara më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.2/2025 datë 27.11.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës; në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.